



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRE E DOKUMENTSKROLL - ARKIVËS
NR. 1117/38 PROT.
DATA 22.10.2025



UNIVERSITETI I VLORËS
ISMAIL QEMALI

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr.....Prot.

Vlorë me __. __. 2025

SPITALI RAJONAL LUSHNJË

Nr. 1846/11.....Prot.

Lushnjë më 14.11.2025

MARREVËSHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DHE

SPITALIT RAJONAL LUSHNJË

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i arsimit të lartë publik, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektor i Universitetit

dhe

Spitali Rajonal Lushnjë, përfaqësuar nga Drejtor Z. Roland Ziu.

Nisur nga interesi i përbashkët për zhvillimin e aktiviteteve me karakter arsimor, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm si dhe me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë, palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja").

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 28, pika 5.

Neni 2

Qëllimi dhe mënyra e bashkëpunimit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Universitetit dhe Spitalit duke përfshirë:

Vënien në dispozicion të personelit mjekësor dhe infermieror të spitalit për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të FSH.

Angazhimin e studentëve të FSH në procedurat infermiere të institucionit (nga marrja e anamnezës deri tek ndjekja e terapisë).

Bashkëpunimin e pedagogëve të FSH, personelit mjekësor dhe infermieror të Spitalit, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve klinike dhe kërkimit shkencor mjekësor.

Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).

Sigurimin e praktikave klinike (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushës së shëndetit, të ofruara nga FSH.

Neni 3

Sfera e bashkëpunimit

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
- Shërbimi i Patologjisë
- Shërbimi i Kirurgjisë
- Shërbimi i Pediatriës
- Shërbimi i Obstetrikë-Gjinekologjisë
- Shërbimi Infektiv
- Shërbimi i Urgjencës

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në tre cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor)
- Cikli i tretë i studimeve Doktoraturë

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara
- Praktika mësimore
- Praktika profesionale
- Projektet kërkimore klinike
- Detyrat e kursit mbi bazën e ekzaminimit të rasteve klinike.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 4

Detyrimet e palëve

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Personeli i Fakultetit të Shëndetit, studentët e programeve mësimore të FSH si dhe personeli mjekësor i Spitalit Rajonal Lushnjë janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakord nga titullarët e të dy institucioneve.

Neni 5

Detyrime financiare

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje institucionet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar.

Neni 6

Amendamente

Amendamentet e mundshme ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të Marrëveshjes.

Neni 7

Respektimi i Marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, forcës madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, të shkaktuara përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 8

Mirëbesimi

Universiteti dhe Spitali Rajonal Lushnjë do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 9





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Afati i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.

Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo Marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 10

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Kjo Marrëveshje është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe; nga një kopje do të depozitohet në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe Fakultetin e Shëndetit, një kopje do të depozitohet në Spitalin Rajonal Lushnjë.

PËR

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

PROF.DR. AURELA SALIAJ

A Saliaj



PËR

SPITALIN RAJONAL LUSHNJË

DREJTOR

ROLAND ZIU

[Signature]

